



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE

Nr. 2065 Prot.

Tiranë më, 27.06. 2025

UDHËZIM

Nr. 2, datë 27.06.2025

PËR

**PROCEDURËN DHE KRITERET E APLIKIMIT PËR REGJISTRIMIN E
ORGANEVE TË VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT PËR SIGURINË
KIBERNETIKE PRANË AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË
KIBERNETIKE**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 42, të ligjit nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike”,

UDHËZON:

1. Të gjithë personat juridik, vendas apo të huaj që kërkojnë të regjistrohen pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, si Organe të Vlerësimit të Konformitetit për Sigurinë Kibernetike për të kryer vlerësimet dhe testimet e konformitetit të produkteve, shërbimeve dhe proceseve TIK, sipas skemës së certifikimit të sigurisë kibernetike, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) të jenë të akredituar nga Autoriteti përgjegjës për akreditimin;
 - b) të jenë të regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si person juridik me status aktiv;
 - c) të mos jenë në ndjekje penale;
 - ç) të mos jenë në proces gjyqësor lidhur me ushtrimin e aktivitetit;
 - d) të mos jenë i dënuar nga organet gjyqësore;
 - dh) të mos kenë detyrime tatimore të pa paguara;
 - e) të mos jenë në proces falimentimi apo likuidimi;
 - ë) të jenë të pavarur nga ana ligjore, financiare dhe vendimarrja nga organizata ose produktet TIK, shërbimet e TIK ose proceset TIK që vlerësojnë.
 - f) të mos jenë në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera në zyrën e përmbartimit gjyqësor;
 - g) të kenë personel kompetent dhe të kualifikuar që zotëron ekspertizën dhe njohuritë e nevojshme teknike në lidhje me fushën specifike të vlerësimit të konformitetit;

- gj) të kenë kapacitetet dhe aftësi organizative, teknike e fizike dhe i plotëson standardet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen dhe administrimin e informacionit të klasifikuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar.
 - h) të kenë personel që plotëson kushtet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar.
2. Personi juridik për t'u regjistruar pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike si Organ i Vlerësimit të Konformitetit për Sigurinë Kibernetike duhet të paraqesë dokumentat si më poshtë:
- a) certifikatën e akreditimit nga Autoriteti përgjegjës për akreditimin në Republikën e Shqipërisë ose ndërkombëtar;
 - b) ekstraktin nga QKB-ja, ku të vërtetohet se shoqëria është me status aktiv;
 - c) vërtetim të lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatave të Juridiksionit përkatës se ndaj subjektit nuk është filluar çështje penale që ka lidhje me aktivitetin;
 - ç) vërtetim të lëshuar nga Gjykata e Juridiksionit përkatës se nuk është në proces gjyqësor lidhur me aktivitetin;
 - d) vërtetim të gjendjes gjyqësore që tregon se subjekti nuk është i dënuar;
 - dh) vërtetim nga organet tatimore ku subjekti është i regjistruar, ku vërtetohet se nuk ka detyrime tatimore të pa paguara;
 - e) statutin dhe aktin e themelimit të shoqërisë;
 - ë) vërtetim nga zyra përmbarimore që subjekti nuk është në proces ekzekutimi të detyueshëm pasuror;
 - f) vërtetim që subjekti nuk është në procedura falimentimi;
 - g) certifikata e sigurisë industriale (CSI) nga institucioni përgjegjës për informacionin e klasifikuar në Republikën e Shqipërisë.
 - gj) listën e emrave të punonjësve me funksionet organike përkatëse për të cilët subjekti ka bërë kërkesë pranë Autoritetit përgjegjës për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar për pajisjen e tyre me Certifikatën e Sigurisë së Personelit (CSP) në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar në Republikën e Shqipërisë.
3. Dokumentat e përmendura në pikën 2 të këtij udhëzimi të jenë origjinale ose kopje të njësuar me origjinalin dhe të jenë të lëshuara brenda tre muajve të fundit nga organet kompetente.
4. Dorëzimi i dokumentacionit nga organet e vlerësimit të konformitetit sipas pikës 2 të këtij udhëzimi bëhet nëpërmjet postës zyrtare/dorazi pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.
5. Afati për shqyrtimin e dokumentacionit nga ana e Autoritetit është 30 ditë nga dorëzimi, ku në rast mungese të dokumentacionit, organi i vlerësimit të konformitetit, njoftohet dhe i lihet një afat 15 ditor për plotësimin e mangësive në dokumentacion.
6. Autoriteti kur konstaton mungesë të dokumentacionit të parashikuar në pikën 2 të këtij udhëzimi edhe pas ezaurimit të afatit për përmbushjen e mangësive në

dokumentacion sipas pikës 5 të këtij udhëzimi, kthen përgjigje për mosregjistrimin organit të vlerësimit të konformitetit, si dhe arsyet përkatëse.

7. Autoriteti kur konstaton plotësimin e kriterëve sipas këtij udhëzimi, regjistron subjektin të ushtrisë veprimtarinë si organ i vlerësimit të konformitetit si dhe e njofton atë brenda 7 ditësh për regjistrimin e tij.
8. Lista e organeve të vlerësimit të konformitetit për sigurinë kibernetike miratohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm dhe publikohet në faqen zyrtare të autoritetit.
9. Ngarkohet Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike për zbatimin e këtij udhëzimi.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

IGLI TAFA





REPUBLIC OF ALBANIA
NATIONAL CYBER SECURITY AUTHORITY

DIRECTIVE

No. __, date __. __. 2025

ON

**“THE PROCEDURE AND CRITERIA FOR THE APPLICATION AND
REGISTRATION OF CONFORMITY ASSESSMENT BODIES WITH THE
NATIONAL CYBER SECURITY AUTHORITY”**

In support of point 2 of article 42 of the law no. 25/2024 "On Cyber Security",

IT IS HEREBY DIRECTED:

1. All legal entities, whether domestic or foreign, seeking registration with the National Cyber Security Authority, as Conformity Assessment Bodies for the purpose of conducting conformity assessments and testing of ICT products, services and processes, as well as the assessment of cybersecurity measures implemented by critical and important information infrastructures, must fulfil the following criteria:
 - a) be accredited by the competent accreditation Authority;
 - b) be registered with the National Business Centre as a legal entity with active status;
 - c) not be under criminal prosecution;
 - ç) not be in ongoing judicial proceedings related to the exercise of the activity;
 - d) not be convicted by the judicial bodies;
 - dh) have no unpaid tax liabilities;
 - e) not be undergoing bankruptcy or liquidation proceedings;
 - ë) be legally, financially, and decision-making independent from any organization, ICT product, ICT service, or ICT process subject to its assessment;
 - f) not be in the process of compulsory execution for unpaid property liabilities at the Judicial Enforcement Office;
 - g) Employ competent and qualified personnel possessing the necessary technical expertise and knowledge relevant to the specific field of conformity assessment;
 - gj) possess the organizational, technical and physical capacities and abilities and meet the established standards for the recognition, storage and administration of classified information in accordance with the applicable legislation on classified information;
 - h) Employ personnel who meet the required conditions for the recognition, storage, administration and transfer of classified information in accordance with the applicable legislation on classified information;

2. In order to be registered with the National Cyber Security Authority as a Conformity Assessment Body, the legal entity must submit the following documents:
 - a) the accreditation certificate issued by the competent accreditation authority in the Republic of Albania or by an internationally recognized body;
 - b) an extract from the National Business Centre, confirming that the company has an active status;
 - c) an attestation issued by the Prosecutor's Office at the Courts of competent Jurisdiction confirming that no criminal proceedings related to the entity's activity has been initiated against the it;
 - ç) an attestation issued by the Court of competent Jurisdiction that the entity is not involved in any ongoing judicial proceedings related to its activity;
 - d) a criminal record attestation indicating that the entity is not convicted;
 - dh) an attestation issued by tax authorities where the entity is registered, confirming that there are no unpaid tax liabilities;
 - e) the company's statute and act of incorporation;
 - ë) an attestation issued by the Enforcement Office that the entity is not in the process of executing deductible assets;
 - f) an attestation confirming that the entity is not undergoing bankruptcy proceeding;
 - g) the Industrial Security Certificate (ISC) issued by the competent authority for classified information in the Republic of Albania.
 - gj) A list of employees, including their respective official functions, for whom the entity has submitted a request to the National Authority for Classified Information Security (AKSIK) for the issuance of Personnel Security Certificates (PSC), in accordance with the applicable legislation on classified information in the Republic of Albania;
3. The documents referred to in point 2 of this instruction must be either originals or certified true copies of the originals and must be issued within the last three months by the competent bodies.
4. The submission of the documentation by the conformity assessment bodies according to point 2 of this instruction shall be carried out via official mail or delivered in person to the National Cyber Security Authority;
5. The deadline for the review of the documentation by the Authority is 30 days from the submission. In case of missing documentation, the conformity assessment body shall be notified and granted a 15-day period for completing the deficiencies in the documentation.
6. If, upon the expiration of the 15-day period specified in point 5 of this guideline, the documentation required under point 2 remains incomplete, the Authority shall issue a formal response denying the registration of the Conformity Assessment Body, including the respective reasons for such decision.
7. When the Authority ascertains the fulfilment of the criteria according to this instruction, it proceeds with the registration of the entity to exercise the activity as a conformity assessment body and notifies the entity of its registration within 7 days.
8. The list of conformity assessment bodies is approved by order of the Director General and published on the official website of the authority.

The National Cyber Security Authority is charged with the implementation of this instruction.

GENERAL DIRECTOR

IGLI TAFA